



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar  
të Inspektorit  
të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor



Tiranë 2021

# Tabela përmbledhëse

---

Shkurtesa.....	3
<b>INSPEKTORATI SHETETËROR SHËNDETËSOR .....</b>	<b>4</b>
Objektivat e ISHSH.....	4
Misioni dhe funksionet e ISHSH .....	4
Organizimi i veprimtarisë inspektuese të ISHSH .....	5
<b>Moduli 1.....</b>	<b>5</b>
Objektivi.....	5
Metodologjia .....	5
<b>Moduli 2.....</b>	<b>8</b>
Inspektimi Shëndetësor .....	8
Objektivi.....	8
<b>Moduli 3.....</b>	<b>13</b>
<b>INSPEKTIMI PËR LIGJE SEKTORIALE .....</b>	<b>13</b>
Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.....	13
Objektivi.....	13
Ligji nr. 9518 datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar .....	16
Objektivi.....	16
Ligji nr. 9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar .....	17
Objektivi.....	17
Metodologjia .....	18

# Shkurtesa

---

IQ            Inspektorati Qendror  
ISHSH       Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor  
KNMSHPD

# INSPEKTORATI SHETËTOR SHËNDETËSOR

---

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është institucioni përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

## Objektivat e ISHSH

- Të rrisë sigurinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ofrojë transparence dhe metoda sa më bashkëkohore për kryerjen e kontrolleve nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga një staf i përgatitur inspektorësh.
- Të krijojë një sistem të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave Brenda fushës që ai mbulon.
- Të ndërgjegjësojë subjektet e inspektimit për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë shëndetësore, duke synuar plotësimin e kushteve që kërkohen të arrihen për integrimin Evropian.
- Të mbrojë konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e shëndetësisë.
- Të ndërgjegjësojë operatorët e biznesit shqiptarë dhe konsumatorëve lidhur me praktikën e mira të higjienës shëndetësore që duhet të aplikohen në të gjithë fushën e aktivitetit të ISHSH.

## Misioni dhe funksionet e ISHSH

- Bashkërendimin dhe koordinimin efikas të veprimtarisë në fushat të cilat janë në kompetencë të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke përjashtuar inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike;
- Sigurimin dhe unifikimin e praktikave më të mira të inspektimit, në shkallë vendi;
- Informimin e publikut për veprimtarinë e inspektimit;
- Dhënien e mbështetjes teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit;
- Përgatitjen e programit dhe raportit vjetor të inspektimit.

## Organizimi i veprimtarisë inspektuese të ISHSH

ISHSH organizohet në dy nivele: Në nivel qendror dhe atë rajonal për çdo qark të vendit.

ISHSH qendror, drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit, i cili në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHSH.

## Moduli 1

- ✓ Ligji Nr.7643, datë 2.12.1992, “Për Inspektimin Sanitar”, ( i ndryshuar)
- ✓ Udhëzim Nr. 510 datë 13.12.2011 “ Për inspektimet higjiene sanitare në funksion të lëshimit të Akt-Miratimit higjiene sanitar”

### Objektivi

- Njohja me objektet e inspektimit sanitar.
- Kompetencat e ISHSH, në këtë ligj.
- Bashkëveprimi me institucionet e tjera në rastet flagrante të shkeljeve të këtij ligji.
- Kundravajtjet administrative sanitare dhe masat që merren nga inspektori në varësi të rrethanave të rastit si dhe vlerësimi i tyre si masa urgjente apo dënime plotësuese.

### Metodologjia

- Prezantime në Power Point me ligjin për inspektimin sanitar
- Ushtrime praktike për situata të ndryshme inspektimi duke e shoqëruar me demonstrim situatash praktike, në sistemin online *E-inspektimi*
- Punë në grupe

### Kohëzgjatja

Trajnimi realizohet duke u programuar i ndryshëm për nivelin e inspektorit fillestar, me atë të inspektorit për trajnimin dhe testimin periodik. Ky trajnim do të zgjasë rreth 4 orë e 30 minuta.

## Tematikat që do të zhvillohen

- Kompetencat e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit
- Objektet e inspektimit sanitar
- Kundravajtjet administrative sanitare
- Dokumentacioni i detyrueshëm higjieno sanitar dhe shëndetësor
  - Akt-Miratimi higjieno sanitar
  - Dokumentacioni vërtetues për aplikimin e lëndëve biocidë në subjekt (Certifikata DDD)
  - Raport analiza për ujin e pijshëm
  - Librezat Shëndetësore të punonjësve (sipas llojit të aktivitetit sipas përcaktimit të ligjit 15/2016, neni 17)
  - Raporti mjeko-ligjor i punonjësve.
  - Dokumente të tjera specifike sipas llojit të aktivitetit të subjektit.
- Akt –Miratimi higjieno sanitar dhe kushtet që duhet të plotësojë subjekti për t'u pajisur me këtë dokument.
  - Mjedisi i brendshëm
  - Kushtet mjedisore të mjedisit të brendshëm
  - Furnizimi me ujë të pijshëm
  - Pajisjet teknologjike
  - Nyjet sanitare
  - Punonjësit
  - Mjetet e transportit

## Masat Administrative

Për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimeve sanitare merren masat administrative sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, subjekti i inspektimit dënohet me "paralajmërim". Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor. Përshkallëzimi i masave administrative bëhet vetëm pasi subjektet janë paralajmëruar nga inspektorët mbi shkeljet sanitare dhe nuk kanë korrigjuar këto shkelje sipas detyrave të lëna sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Për kundërvajtjet administrative sanitare inspektorati që mbulon fushën e shëndetit vendos dënimin kryesor me gjobë.

Masat që merren nga inspektorati, sipas këtij ligji, në varësi të rrethanave të rastit, mund të vlerësohen nga vetë inspektorati si masa urgjente ose dënime plotësuese. Ndërsa masa e pezullimit ose e mbylljes së përkohshme a të përhershme të objektit, apo veprimtarisë sipas këtij ligji, janë

dënime plotësuese. Kur shkeljet administrative sanitare janë me pasoja të rënda për shëndetin e njerëzve, çështja denoncohet për ndjekje penale në organet e prokurorisë.

## Masat Urgjente

Në rastet kur organet e kontrollit të shërbimit epidemiologjik, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, konstatojnë shkaqe, të cilat vënë në rrezik jetën, shëndetin apo përbëjnë potencial për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, marrin të gjitha masat urgjente të nevojshme dhe njoftojnë menjëherë inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.

Inspektorët e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit kërkojnë mbështetjen e strukturave të shërbimit epidemiologjik sa herë që vlerësohet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre në lidhje me parandalimin, kufizimin dhe eliminimin e pasojave të dëmshme për shëndetin.

## Pezullimi i Veprimtarisë së Subjektit

1. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit pezullon ose ndalon veprimtarinë në objektet që i nënshtrohen kontrollit të tij në këto raste:

- *Kur nuk plotëson kushtet sanitare të pajtueshme me projektin e miratuar dhe me qëllimin, për të cilin ato janë ngritur;*
- *Kur në to ka në përdorim materiale ose tregtohen artikuj që nuk përputhen me normat sanitare në fuqi dhe për pasojë paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve.*

Për objektet me karakter kombëtar, vendimi jepet nga Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në Ministrinë e Shëndetësisë, kurse për objektet me karakter lokal, vendimi jepet nga Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, të rrethit përkatës.

2. Ankimi ndaj kësaj mase bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
3. Rihapja e veprimtarisë bëhet përsëri me vendim të inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit, kur plotësohen kushtet e kërkuara.

## Ankimi dhe ekzekutimi i vendimit

Ankimi administrativ kundër vendimit përfundimtar paraqitet dhe shqyrtohet pranë “organit epror” (trupës kolegjiale) të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

## Procedura e Inspektimit kryhet online

- ✓ Gjenerimi i autorizimit të inspektimit
- ✓ Plotësimi i listë verifikimeve specifike sipas llojit të aktivitetit të subjektit.
- ✓ Plotësimi i procesverbalit të inspektimit
- ✓ Gjenerimi i Vendim Përfundimtar të Inspektimit

## Moduli 2

---

### Inspektimi Shëndetësor

- ✓ Ligji nr. 10 107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”

### Objektivi

- Njohja me parimet e kujdesit shëndetësor
- Strukturën dhe organizimin e sistemit shëndetësor
- Mbikëqyrja e jashtme-inspektimi i institucioneve shëndetësore
- Standardet bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të Institucioneve shëndetësore.
- Kundravajtjet administrative në rastet e ofrimit të kujdesit shëndetësor në kundërshtim më dispozitat e ligjit për kujdesin shëndetësor.
  
- Qëllimi i ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive
- Parimet për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive
- Masa të përgjithshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive
- Masa të veçanta për mbrojtjen nga sëmundjet infektive
- Kundravajtjet administrative për moszbatimin e kërkesave të ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive.



## Metodologjia

- Prezantime në Power Point për inspektimin shëndetësor.
- Ushtrime praktike për situata të ndryshme inspektimi duke e shoqëruar me demonstrim situatash praktike, në sistemin online *E-inspektimi*
- Punë në grupe

## Kohëzgjatja:

Trajnimi realizohet duke u programuar i ndryshëm për nivelin e inspektorit fillestar, me atë të inspektorit për trajnimin dhe testimin periodik. Ky trajnim do të zgjasë rreth 5 orë.

## Tematikat që do të zhvillohen

### Inspektimi i shërbimit shëndetësor parësor

- ✓ Inspektimi i dokumentacionit
- ✓ Inspektimi i ambienteve ku kryhen vizita dhe ekzaminime
- ✓ Inspektimi i laboratorëve mjekësorë
- ✓ Inspektimi i menaxhimit dhe administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore

### Inspektimi i shërbimit spitalor

- ✓ Inspektimi i dokumentacionit
- ✓ Inspektimi i shërbimit të urgjencës dhe procedurat e pranimit
- ✓ Inspektimi i pavioneve
- ✓ Inspektimi i laboratorëve mjekësorë dhe ambienteve ku kryhen ekzaminime imazherike dhe të tjera
- ✓ Inspektimi i menaxhimit dhe administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore

### Inspektimi i shërbimit stomatologjik

- ✓ Inspektimi i dokumentacionit
- ✓ Kushtet fizike dhe sipërfaqja e ambienteve të kabineteve /klinikave dentare
- ✓ Pajisja e klinikave/kabineteve dentare

### Inspektimi i shërbimit shëndetësor në punë

- ✓ Inspektimi i dokumentacionit që duhet të plotësojë mjeku i punës
- ✓ Inspektimi fizik i ambienteve ku kryen veprimtarinë mjeku i ndërmarrjes.

## **Inspektimi i masave të përgjithshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive**

- ✓ Sigurimi i ujit të pijshëm higjienik, si dhe mbrojtja sanitare e burimeve, objekteve dhe rrjetit shpërndarës, për furnizimin publik me ujë të pijshëm;
- ✓ mënjanimi i ujërave të ndotura dhe hedhurinave, sipas mënyrës dhe në kushtet në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve;
- ✓ ruajtja e kushteve tekniko-sanitare dhe higjienike në ndërtesa publike dhe jopublike, në mjetet e komunikacionit publik dhe në mjediset publike
- ✓ sigurimi i gjendjes së rregullt sanitare të artikujve ushqimorë dhe të kushteve higjieno sanitare për prodhimin, qarkullimin dhe ruajtjen e tyre
- ✓ aplikimi i lëndëve biocide, me karakter parandalues, në qendrat e banuara, hapësirat publike, objektet për furnizim me ujë të pijshëm, në objektet dhe mjetet e transportit publik, objektet për prodhimin dhe qarkullimin e artikujve ushqimorë, restorantet apo lokalet ku konsumohet ushqim dhe pije dhe në objekte të tjera publike;
- ✓ sigurimi i mjeteve të mbrojtjes personale, që shërbejnë për mbrojtjen e punonjësve të shëndetësisë dhe personave të tjerë të ekspozuar ndaj agjentëve infektues nga kontaminimi, infektimi dhe prekja nga sëmundjet infektive;
- ✓ sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme për parandalimin e sëmundjeve infektive dhe për izolimin dhe karantinën, në veçanti;
- ✓ sigurimi i burimeve njerëzore të arsimuara për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive;
- ✓ informimi, komunikimi, promovimi i shëndetit dhe edukimi i vazhdueshëm shëndetësor i personelit të organizatave shëndetësore dhe joshëndetësore, si dhe i popullatës.

## **Inspektimi i masave të veçanta për parandalimin e sëmundjeve infektive**

- ✓ zbulimi në kohë i burimit të infeksionit dhe rrugëve të marrjes e përhapjes së tij; survejanca epidemiologjike dhe njoftimi i hershëm dhe i shpejtë;
- ✓ izolimi dhe karantina;
- ✓ transportimi i sigurt;
- ✓ diagnoza e saktë dhe në kohë reale mikrobiologjike;
- ✓ trajtimi dhe shërimi i personave të sëmurë;
- ✓ gjurmimi i kontakteve me persona të infektuar apo të sëmurë, sipas udhëzimeve dhe listës së sëmundjeve, të miratuar me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas propozimeve të Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës Epidemike;
- ✓ aplikimi i detyruar i lëndëve biocide, sipas listës së sëmundjeve, të miratuar me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- ✓ aplikimi i programeve të kontrollit të vektorëve;
- ✓ mbikëqyrja shëndetësore e personave të punësuar në profesione të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe personave mbartës të mikrobeve;

- ✓ kontrolli i infeksioneve në institucionet e kujdesit shëndetësor, sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë;
- ✓ imunoprofilaksia, seroprofilaksia dhe kimioprofilaksia;
- ✓ kontrolli i vektorëve, nëpërmjet produkteve biocide.

### **Mbikëqyrja shëndetësore ndaj personave që mund të transmetojnë sëmundje infektive**

Nën mbikëqyrje shëndetësore, për parandalimin e sëmundjeve infektive, vihen personat që:

- ✓ Punojnë në prodhimin dhe tregtimin e artikujve ushqimorë apo që punojnë në furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm, të cilët, në punët dhe detyrat e tyre të punës, vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me artikujt ushqimorë, përfshirë ujin e pijshëm;
- ✓ Shërbejnë në institucionet shkollore dhe parashkollore, çerdhe dhe kopshte;
- ✓ Shërbejnë në institucionet shëndetësore, që merren me kontrollin, trajtimin, mjekimin dhe kujdesin ndaj të sëmurëve, në prodhimin dhe dhënien e medikamenteve;
- ✓ Shërbejnë në institucione të përkujdesjes sociale;
- ✓ Punojnë në shërbime të tilla si banjë publike, qendra estetike dhe shërbime të ngjashme;
- ✓ Hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vijnë nga vende endemike, me sëmundje infektive, të cilat trajtohen sipas konventave ndërkombëtare shëndetësore dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

## **Kundravajtjet Administrative**

### **Ofrimi i kujdesit shëndetësor në kundërshtim me ligjin për kujdesin shëndetësor përbën kundërvajtje administrative**

- ✓ Mos përmbushja e detyrimeve të parashikuara të lidhura me standardet e përgjithshme dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dënohet me gjobë dhe, në raste të përsëritura, me heqje licence.
- ✓ Refuzimi nga ofruesi i shërbimit i procesit të mbikëqyrjes shtetërore, të ushtruar nga institucionet përgjegjëse, dënohet me gjobë.
- ✓ Shkelja e neneve mbi licencimin dhe akreditimin nga personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, që ofrojnë kujdes shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, dënohet me gjobë dhe, në rast përsëritjeje, me 5-fishin e gjobës dhe denoncim në organet kompetente.
- ✓ Mos regjistrimi i profesionistëve të shëndetësisë, dënohet me gjobë.

## **Ankimi**

Kundër vendimit të Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë mund të bëhet ankimi pranë Ministrin të Shëndetësisë.

- Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

### **Kundërvajtjet administrative në ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, kur nuk përbëjnë vepër penale**

- ✓ Mos raportimi i sëmundjeve infektive
- ✓ Mos marrja e masave të përgjithshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive
- ✓ Mos marrja e masave të veçanta, për mbrojtjen nga sëmundjet infektive
- ✓ Refuzimi për vendosjen nën mbikëqyrje shëndetësore, dënohet si për personin objekt i mbikëqyrjes shëndetësore, dhe për punëdhënësin e personit objekt i mbikëqyrjes shëndetësore;
- ✓ Moszbatimi i kalendarit të vaksinimit të detyrueshëm, mos regjistrimi i personave që duhen vaksinuar, mos mbajtja në kushte i “zinxhirit të ftohtë” të vaksinave, korrigjimi i dokumenteve të vaksinimit.
- ✓ Moskryerja e veprimeve të detyrueshme për përballimin e epidemive dënohet me gjobë dhe me mbyllje të veprimtarisë;
- ✓ Moszbatimi i masave të domosdoshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive në kohë, sipas detyrave të lëna nga organet kompetente

*Masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete, dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e mbylljes së aktivitetit.*

*Inspektorati Shtetëror Shëndetësor njofton Shërbimin Kombëtar të Inteligjencës Epidemike për masën e marrë.*

*Në raste kur nevojiten ndërhyrje të menjëhershme, Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike merr masa administrative për mbyllje të veprimtarisë dhe njofton Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor.*

*Procedurat e shqyrtimit dhe dhënies së masave administrative dhe të ankimit të vendimit administrativ bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative*

## Procedura e Inspektimit kryhet online

- Gjenerimi i autorizimit të inspektimit
- Plotësimi i listë verifikimeve specifike sipas llojit të aktivitetit të subjektit.
- Plotësimi i procesverbalit të inspektimit
- Gjenerimi i Vendim Përfundimtar të Inspektimit

## Moduli 3

---

### INSPEKTIMI PËR LIGJE SEKTORIALE

- ✓ Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit
- ✓ Ligji nr. 9518 datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 8528, date 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar

### Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit

#### Objektivi

- Mbrojtja e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.

#### Tematikat që do të zhvillohen

- Njohja me ndryshimet ligjore që ka pësuar ligji i mbrojtjes nga produktet e duhanit.
- Njohja me përcaktimet e ligjit për ambientet e mbyllura dhe të hapura ku konsumohet duhan.
- Roli i institucioneve të ndryshme dhe ndarja e subjekteve të inspektimit në varësi të kompetencave të këtyre institucioneve.
- Forma dhe përmbajtja e paketimeve të produkteve të duhanit sipas KNMSHPD.

- Masat kufizuese për përdorimin e produkteve të duhanit si dhe ato ndaj reklamave, promovimit dhe sponsorizimit.
- Njohja me kundravajtjet administrative dhe ushtrime për raste të ndryshme gjetjesh.

## **Kundravajtjet Administrative që janë kompetencë e ISHSH**

- Përbëjnë kundravajtje administrative të gjitha rastet kur forma dhe paketimi i produkteve të duhanit janë në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e mesazheve që përcaktohen nga KNMSHPD-ja.
- Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.
- Ndalohet shitja e produkteve të duhanit në:
  - Në institucionet shëndetësore;
  - Në institucionet arsimore;
  - Në institucionet sportive;
  - Në makinat shitëse automatike;
  - Me anë të vetëshërbimit;
  - Në rrugë nga shitësit ambulantë;
  - Nëpërmjet shërbimit postar.
  - Shitja me pakicë e produkteve të duhanit të pa paketuara ose me paketim të dëmtuar.
  - Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve, si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intensitetin e tymit.
  - Ndalohet ofrimi falas i produkteve të duhanit nga subjektet që i prodhojnë, i importojnë ose i tregtojnë ato.
- Ndalohet reklamimi
  - Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit.
  - Ndalohet çdo lloj forme tjetër reklamimi e produkteve të duhanit, përfshirë promovimin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promovimin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani.”
  - Ndalohet, për qëllime reklame apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona që pinë duhan dhe i imazheve që krijojnë përshtypje të gabuar te

publiku për karakteristikat e produkteve të duhanit, efektet e përdorimit të tyre në shëndet, rreziqet dhe/ose dëmet.

- Sponsorizimi i programeve radiofonike, televizive dhe i çdo veprimtarie tjetër nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë të tyre prodhimin, importimin apo tregtimin e produkteve të duhanit dhe kur ky sponsorizim ka për qëllim promovimin apo reklamën e produkteve të duhanit.
- Ndalohet pirja e duhanit në:
  - mjediset e punës;
  - institucionet shëndetësore, me përjashtim të institucioneve të shëndetit mendor (vetëm për pacientët);
  - mjediset e mbyllura tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës;
  - dh) mjediset e mbyllura kulturore e sportive;
  - mjediset e tjera publike të mbyllura.

## **Masat administrative**

Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare merren masat administrative sipas kërkesave të këtij ligji.

Përshkallëzimi i masave administrative për shkeljet e përsëritura të këtij ligji bëhet:

- Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur (gjobës 300.000 lekë) ndaj subjektit të tatueshëm.
- Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë, gjendet përsëri në shkelje të nenit 15, brenda një afati kohor 1-vjeçar, atëherë ndaj tij vendoset gjoba në vlerën e gjashtëfishit të gjobës së vendosur (gjobës 300.000 lekë), dhe pezullim i aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.

## **Ankimimi**

Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

# **Ligji nr. 9518 datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar**

## **Objektivi**

Parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar nëpërmjet përdorimit të tyre nga të miturit.

## **Tematikat që do të zhvillohen**

- Njohja me ndryshimet ligjore që ka pësuar ligji i mbrojtjes nga konsumimi i produkteve të alkoolit nga të miturit
- Njohja me masat detyruese të subjekteve objekt i këtij ligji për mbrojtjen e të miturve nga alkooli dhe pijet energjike.
- Kundravajtjet administrative të subjekteve që tregtojnë, ofrojnë alkool dhe pije energjike tek të miturit.
- Kundravajtjet administrative të subjekteve që reklamojnë produktet alkoolike, pijet energjike dhe atyre me sheqer të shtuar.
- Roli i institucioneve të ndryshme dhe ndarja e subjekteve të inspektimit në varësi të kompetencave të këtyre institucioneve.

## **Kundravajtjet Administrative që janë kompetencë e ISHSH**

- Ndalohet tregtimi nga njësitë tregtare i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike të miturve.
- Ndalohet tregtimi apo ofrimi falas i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga baret, restorantet ose klubet e natës të miturve.
  - Ndalohet ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhore që shoqërojnë të miturit në njësi tregtare.
  - Ndalohet ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhor që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet, kinematë apo klubet e natës.
- Ndalohet frekuentimi nga të miturit i klubeve të natës, në të cilat tregtohen pije alkoolike dhe pije energjike.
- Mungesa e tabelave treguese me shënimin “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç” dhe Ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç në njësitë tregtare, bare, restorante ose klube nate.



## **Masat administrative**

Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare merren masat administrative sipas kërkesave të këtij ligji.

## **Ankimimi**

Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

## **Ligji nr. 9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar**

## **Objektivi**

Parandalimi i çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

## **Tematikat që do të zhvillohen**

- Detyrimet për jodizimin e kripës për konsum njerëzor dhe shtazor, nivelet e jodizimit të kripës:
  - Niveli i jodizimit për kripën e prodhuar në vend
  - Niveli i jodizimit për kripën e importuar
  - Niveli minimal i jodizimit për kripën që hidhet në treg
- Kundravajtjet administrative të këtij ligji.
- Roli i institucioneve shtetërore në lidhje me monitorimin dhe inspektimin e kripës së jodizuar.

## **Kundravajtjet Administrative që janë kompetencë e ISHSH**

- ✓ Ndalohet importimi, prodhimi, shpërndarja, tregtimi apo marketingu i kripës së pajodizuar ose me nivel jodi më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, për konsum njerëzor e shtazor me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

- ✓ Ndalohet përdorimi i kripës së pajodizuar ose i kripës së jodizuar, me një nivel më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, në industrinë ushqimore me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.
- ✓ Ndalohet importimi, shpërndarja, tregtimi apo reklamimi i kripës së jodizuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore pas datës së skadencës, sipas llojit të fortifikimit.
- ✓ Mospërputhja me treguesit e cilësisë, të ambalazhimit, etiketimit, transportit dhe ruajtjes.

### **Kundërvajtjet administrative, të parashikuara si më sipër , dënohen si më poshtë**

- ✓ Gjobë dhe kthim mbrapsht të mallit për pikën e 1
- ✓ Gjobë dhe bllokimin e mallit për pikën e 2
- ✓ Gjobë dhe bllokimin e mallit për shkelje të përsëritur të pikës 3
- ✓ Gjobë dhe bllokimin e mallit, kur kemi mospërputhje me treguesit cilësorë sipas pikës 4
- ✓ Gjobë dhe bllokim dhe riambalazhim të mallit, në përputhje me ligjin, kur shkeljet lidhen me ambalazhimin, etiketimin, transportin dhe ruajtjen, sipas pikës 4.

Masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e bllokimit të mallit.”.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkelje të përsëritur të pikave 3 pikave të para të kundravajtjeve administrative, u propozon institucioneve përkatëse heqjen e licencës për subjektin përgjegjës.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkelje të përsëritur të pikës së 4 të kundravajtjeve administrative, u propozon institucioneve përkatëse pezullimin e përkohshëm ose të përhershëm të veprimtarisë së subjektit prodhues.

## **Ankimimi**

Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

## **Metodologjia**

- Prezantime në Power Point për inspektimin e ligjeve të veçanta.
- Ushtrime praktike për situata të ndryshme inspektimi duke e shoqëruar me demonstrim situatash praktike, në sistemin online *E-inspektimi*
- Punë në grupe

## **Procedura e Inspektimit kryhet online**

- Gjenerimi i autorizimit të inspektimit
- Plotësimi i listë verifikimeve specifike sipas llojit të aktivitetit të subjektit.
- Plotësimi i procesverbalit të inspektimit
- Gjenerimi i Vendim Përfundimtar të Inspektimit

### **Kohëzgjatja:**

Trajnimi realizohet duke u programuar i ndryshëm për nivelin e inspektorit fillestar, me atë të inspektorit për trajnimin dhe testimin periodik. Ky trajnim do të zgjasë rreth 5 orë



*Inspektorati Qendror*

Tiranë, 2021